



Vdes 41-vjeçari që ishte plagosur në Kryshec të Pejës

KRONIKA | July 05, 2022 - 16:47

SHPËRNDAJE: [f](#) [t](#)

Policia e Kosovës më datën 28.06.2022, rreth orës 20:53, është informuar për të shtëna me armë zjarri, në afërsi të një lokali në fshatin Kryshec të Pejës.

Sipas njoftimit të PK-së thuhet se pas informatës së marrë policia menjëherë i është përgjigjur vendit të ngjarjes, dhe është kuptuar se dy persona kanë pësuar lëndime trupore nga arma e zjarrit, raporton Zeri.info.


“Viktimat fillimisht janë dërguar në Spitalin rajonal të Pejës, e më pas viktima I.G. 1981 është dërguar në Qendrën Klinike Universitare ne Prishtinë pasi që kishte lëndime të rënda trupore. Ndërsa viktima tjetër F. G. 1992 ishte lënduar lehtë dhe pas tretmanit mjekësorë është liruar në shtëpi”, thuhet në njoftimin e PK-së.

Tutje në njoftim thuhet se në vend ngjarje kanë dalë të gjitha njësitet kompetente të Drejtorisë Rajonale të Policisë në Pejë, dhe pas një pune intensive operative dhe hetimore është arritur të identifkohet dhe arrestohet i dyshuari J.G. (1977). Pas intervistimit të tij me urdhër të Prokurorit të shtetit të dyshuarit iu është caktuar masa e ndalimit prej 48-orësh.

“Sot me datën 05.07.22 rreth orës 12:00 Policia është njoftuar nga Qendra Klinike Universitare në Prishtinë se viktima I.G. 1981 ka ndërruar jetë. Në konsultim me Prokurorin e shtetit rasti nga Vrasje në tentativë është ri kualifikuar në Vrasje të rëndë, ndërsa trupi i pa jetë i viktimës me urdhër të Prokurorit të shtetit është dërguar në institutin e mjekësisë ligjore (IML) për obduksion”, thuhet në njoftimin e PK-së.

Rasti është duke u hetuar nga sektori rajonal i hetimeve në Drejtorinë Rajonale të Policisë në Pejë. /Zëri

Të rekomanduara



Arrestohet një ofiqar në Komunën e Prishtinës

July 05, 2022

Ferizaj: Mosmarrëveshjet në rrjete sociale dy të mitur i zgjidhin duke u therur me thikë


KRONIKA | July 05, 2022

Një person i armatosur grabit 3000 euro në një pompë derivatesh në Prizren

KRONIKA | July 05, 2022

Prindërve nga Norvegjia u vdes vajza në Pejë, kishin ardhur për pushime

KRONIKA | July 05, 2022



Arrestohet pejani që dyshohet se i publikoi...

July 05, 2022

Tentuan të hyjnë ilegalisht në Kosovë me autoambulancë, kapen 3 sirianë dhe 3 nga Bangladeshi

KRONIKA | July 05, 2022

Skenderaj: Shtiu me armë për ta kërcënuar babanë e ish-bashkëshortes, arrestohet

KRONIKA | July 05, 2022

Bie në pusët, vdes e mitura në Drenas

KRONIKA | July 05, 2022

Më të lexuarat



KRONIKA | July 05, 2022

Prindërve nga Norvegjia u vdes vajza në Pejë, kishin ardhur për pushime



KRONIKA | July 04, 2022

Kërkohet paraburgimi i dy Lushtakëve që dyshohet se sulmuan policët në Skenderaj, Nuredin Lushtaku në kërkim



KRONIKA | July 04, 2022

Detaje se si ndodhi incidenti mes Lushtakëve dhe policëve



KRONIKA | July 05, 2022

Junik: Gjenden armë ilegale në stane, arrestohet 68-vjeçari



KRONIKA | July 04, 2022

Sulmohet me armë zjarri një person në Prekaz të Skenderajt



KRONIKA | July 05, 2022

Skenderaj: Shtiu me armë për ta kërcënuar babanë e ish-bashkëshortes, arrestohet